

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Këshilli i Marrëdhënieve Shqiptaro-Amerikane mbledh në Nju Jork drejtues politikë dhe përfaqësues të di asporës, në fokus interesat e shqiptarëve në rajon
ADRESA	https://www.gazetatema.net/sociale/keshilli-i-marredhenieve-shqiptaro-amerikane-mbledh-n-e-nju-jork-drejtues-i588757
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	27 shtator 2026, 14:32:58 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	27 shtator 2026, 14:40:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	e5f6144d3ae569fc9d6fc865af26f7f454634eb67606f1d877b7345ba292c4de
TEKSTI	eafe3ce766f178698095f85c2842dc8fc3cfc6d92a3a2ef4d08bca1824688a28
PAMJA	874e5e89be25a7363e21ddcd7f3e487ab46362fbe46ee4c647aa0b7ee58106be

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	fdd9d89e2bffcbbc63e7a9e99b2d435961334ce22fead08607480753cc84ec935
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	3dbf5264f26ae921c8f8735760cb378b1b626a14b73f487ffe641eb8f02fca55
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/fdd9d89e2bffcbbc63e7a9e99b2d435961334ce22fead08607480753cc84ec935>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)
- [Hosteni](#)

English

Built and Monetized by

English

Detaje nga incidenti me eksplozive prane bazes RAF ne Britani, arrestohen 5 persona dhe evakuoohen 85 familje Zelensky: Rusia leshoi mbi dy mije drone ndaj Ukraines b

Këshilli i Marrëdhënieve Shqiptaro-Amerikane mbledh në Nju Jork drejtues politikë dhe përfaqësues të diasporës, në fokus interesat e shqiptarëve në rajon



27 Shtator 2026, 16:40 Sociale TEMA



Nju Jork – Këshilli i Marrëdhënieve Shqiptaro-Amerikane (AARC), i udhëhequr nga presidenti i tij Martin Vulaj organizoi në Nju Jork Mbrëmjen e II-të Vjetore Gala, një nga ngjarjet më të rëndësishme politike e shoqërore të komunitetit tonë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Aktiviteti mbledhi bashkë përfaqësues të lartë të diplomacisë, ambasadorë të akredituar në SHBA nga Shqipëria dhe Kosova, drejtues të organizatave OJQ-ve në SHBA, gazetarë, veprimtarë të çështjes kombëtare dhe personalitete të njohura të biznesit e kulturës. Ministri i Jashtëm i Shqipërisë Ferid Hoxha ishte prezent gjithashtu, Zv. Kryeministri dhe Ministri i Jashtëm i Kosovës Glauk Konjufca ishte i pranishëm dhe një nga diskutantët e këtij event.

I ftuar gjithashtu ishte Kryeministri Edi Rama, i cili ndërmjet të tjerave foli mbi rolin e diasporës shqiptare në SHBA, duke vlerësuar kontributin e përhershëm të komunitetit shqiptaro-amerikan si një urë e fuqishme lidhëse diplomacie dhe zhvillimi ekonomik midis SHBA-së dhe trojeve shqiptare, foli mbi partneritetin Strategjik me SHBA, konfirmoi përkushtimin e Shqipërisë për të mbetur një aleat i palëkundur i Uashingtonit në Ballkan. Theksoi mbështetjen për integrimin e Kosovës në NATO dhe thellimin e stabilitetit e të drejtave të shqiptarëve në të gjithë Ballkanin Perëndimor. Folë për integrimin dhe përfshirjen e Shqipërisë në BE dhe mbështetjen luftën për liri të drejtuesve të lartë të UÇK-së që ndodhen në Hagë. Ai tha se Shqipëria është e Zotit e miqve sigurisht dhe e shqiptarëve.

Gjithashtu fjalën në këtë takim të dytë vjetor të AARC me personalitete amerikane dhe të huaja si dhe përfaqësues të trupës diplomatike shqiptare, e morën ish Presidentja e Kosovës znj. Vjosa Osmani, Kryetari i Bashkisë së Prishtinës Përparim Rama, Kryeministri i Maqedonisë së Veriut Hrisjan Mickoski, si dhe gjenerali Wesley Clark. Ish-Komandanti i Lartë i Forcave Aleate të NATO-s në Evropë, gjenerali Clark udhëhoqi fushatën ajrore 78-ditore të vitit 1999 që i dha fund spastrimit etnik dhe regjimit të Slllobodan Millosheviçit në Kosovë.

Fjalën e hapjes e mbajti përfaqësuesi i Këshillit Shqiptaro - Amerikan Eli Rusi, më pas folën Presidenti i AARC z. Martin Vulaj, Burim Rexhaj, etj. Presidenti i AARC-së, Martin Vulaj, foli për rolin e diasporës në SHBA, u ndal edhe tek misioni i Këshillit si një zë i fuqishëm i interesave shqiptare pranë qendrave të vendimmarrjes në Uashington, përfshirë Kongresin Amerikan dhe Departamentin e Shtetit. Vulaj theksoi se bashkëpunimi i ngushtë mes diasporës aktive dhe diplomacisë zyrtare është një domosdoshmëri për të mbrojtur dhe avancuar çështjet kyçe të shqiptarëve në Ballkan.

Mbrëmja Gala shërbeu si një platformë diskutimi për disa nga temat më me peshë siç janë partneriteti strategjik me SHBA, rëndësia e ruajtjes dhe thellimit të aleancës me Uashingtonin si shtyllë e sigurisë dhe zhvillimit në rajon. Sfidat e shqiptarëve në rajon si koordinim i përpjekjeve për të mbështetur të drejtat dhe zhvillimin e shqiptarëve në Shqipëri, Kosovë, Maqedoninë e Veriut dhe Malin e Zi. Nevoja për një dialog konstruktiv, ku zëri kritik i diasporës të dëgjohet me përgjegjësi nga institucionet zyrtare, si dhe fuqizimi i brezit të ri, për nxitjen e përfshirjes së të rinjve shqiptaro-amerikanë në jetën publike dhe politike amerikane.

Përgjatë mbrëmjes u vu theksi te nevoja për nxitjen e investimeve të diasporës në ekonominë shqiptare, si dhe te diplomacia publike si mjet për lartësimin e imazhit të shqiptarëve në arenën ndërkombëtare.

Eventi u shoqërua nën interpretimin e himnit kombëtar shqiptar, himnit amerikan dhe himni i Kosovës, ky ishte edhe një nga momentet më solemne të mbrëmjes gala të AARC-së. Muzikë live pati gjithashtu nga kitaristi me famë ndërkombëtare Faton Maluca, njohur veçanërisht në zhanrin e xhazit dhe këngëtarja e muzikës pop dhe baladave shqiptare Mariza Ikonimi. Kombinimi harmonik i virtuozeve të Faton Macula në kitarë me zërin potent e ekspresiv të Mariza Ikonimit krijoi një nga bashkëpunimet më elegante dhe estetike të skenës muzikore shqiptare. Duke i dhënë një frymë bashkëkohore dhe ndërkombëtare e muzikës shqipe përpara komunitetit shqiptaro - amerikan. Moderatore e programit ishte veprimtarja Belisa Vneshta.

Përtej protokollit brenda sallës ku zhvillohej gala, ngjarja u shoqërua me tone të forta reagimi jashtë dyerve të saj. Dhjetëra shqiptarë të diasporës në Nju Jork u mbledhën në një protestë paqësore kundër pranisë së Kryeministrit Edi Rama. Me pankarta në duar dhe thirrje për ndryshim politik në Tiranë, protestuesit shprehën shqetësimin e tyre për situatën ekonomike, korrupsionin dhe largimin e rinisë nga vendi. Kërkesat e tyre ishin "Bashkohuni me ne. Rama në burg, Berisha në burg". Prania e tyre përballë godinës ku zhvillohej gala nënvizoi pluralizmin dhe opozitarizmin e gjallë që ekziston brenda komunitetit shqiptaro-amerikan, i cili kërkon llogaridhënie nga drejtuesit e shtetit amë.

Aktiviteti u përmbyll me vlerësimin e gjeneral Wesley Clark me medaljen "Kalorësi i Skënderbeut", si dhe të disa figurave të tjera që kanë dhënë një kontribut të shquar për komunitetin dhe për forcimin e lidhjeve historike mes popullit shqiptar dhe atij amerikan si Bruno Selimaj etj. Kjo mbrëmje e dytë, gala e konsolidon AARC-në si një nga faktorët më me ndikim në strukturimin e dialogut transatlantik.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Fluks në shërbimin neuropsikiatrik në Shkodër, faktorët socialë, ekonomikë dhe stresi ndër shtytësit kryesorë

15:50 Sociale

Fusha sportive, pista vrapimi e kënde lojërash, Rama prezanton parkun e ri në Elbasan

12:00 Sociale / 8 komente

Zhvillohet sot "Tiranathlon"/ Ja rrugët ku kufizohet qarkullimi dhe linjat urbane që do të devijojnë

08:50 Sociale



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.